

Deklaratë për media

Reagim i unifikuar i Profesoratit të Universitetit European të Tiranës

Në interes të informimit të drejtë publik, Senati Akademik i Universitetit European të Tiranës sqaron se ndalimi i z. Henri Çili nuk ka asnjë lidhje me veprimtarinë e UET dhe European Education Initiative shpk, që ka në pronësi këtë universitet.

Si një institucion me përvojë 15 vjeçare në arsimin e lartë në Shqipëri, UET gëzon reputacion të lartë dhe vlerësim maksimal sa u përket standarteve të cilësisë, të njohura nga institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare, prej të cilave është licensuar dhe akredituar, ligjërisht.

















Performanca ekselente i ka dhënë këtij Universiteti statusin e një aktori publik me rëndësi kombëtare dhe më gjerë, ndaj ne si anëtarë të Senatit Akademik reagojmë me indignatë ndaj pasaktësive, spekulimeve ose dashakeqësive në raportimin e ngjarjes së sotme, duke sqaruar se thirrja e z. Cili në organet e drejtësisë lidhet me dhënien sqarime mbi Legal Studio shpk, i cili është një entitet krejtësisht i pavarur nga Universiteti European i Tiranës.

UET është universiteti më i madh privat në vend, me numrin më të lartë të studentëve të regjistruar në ciklin e parë, Bachelor, për vitin akademik 2019-2020 dhe renditet i gjashti për numrin e studentëve, ndër të gjitha universitetet publike dhe private, në rang kombëtar.

UET dhe shoqëria që e ka në pronësi, respektojnë të gjitha standardet e mirëadministrimit, sipas legjisllacionit në fuqi në të gjitha aspektet dhe kanë marrëdhënie shumë korrekte me të tretët. Ky institucion u është nënshtruar standardeve më të larta ndërkombëtare në auditim financiar.

Senati Akademik i UET garanton opinionin publik se i gjithë stafi akademik i Universitetit, mbi 100 pedagogë të brendshëm, profesorë dhe anëtarë të Akademisë së Shkencave mbeten të përkushtuar për të vijuar misionin e këtij institucioni të arsimit të lartë, në raport me studentët dhe shoqërinë.



Kryetar: Prof. Dr. Nevila Nika 	
Anëtarë të Senatit Akademik UET	
Prof. Dr. Isuf Kalo 	Prof. Dr. Xhezair Zaganjori 
Prof. Asoc. Dr. Hysen Maceku 	Prof. Asoc. Dr. Arben Dushi
Prof. Dr. Mimoza Durrësi (Fejzo) 	Prof. Dr. Fatos Tarifa 
Prof. Asoc. Dr. Belina Budini 	Prof. Dr. Pirro Priti 
Prof. Asoc. Dr. Tomi Treska 	Prof. Dr. Kristaq Xharo 
Prof. Asoc. Dr. Roland Lami 	Prof. Dr. Drita Kruja 
Prof. Asoc. Dr. Elvin Meka 	Jonila Priti, PhD 
Prof. Dr. Ermira Qosja 	Ana Plaku
Prof. Asoc. Dr. Arlinda Ymeraj	Emanuela Maraj
Prof. Asoc. Dr. Voltisa Lama 	Xhon Musli